

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Sadik Kryeziu, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.N., nga fshati, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale grabitje në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe përgjigjen në ankesë të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit B.N., av. B.K., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.201/2018 të dt. 31.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK me datë 26.03.2019, mori këtë :

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.201/2018 të dt. 31.01.2019, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr. 201/2018 të datës 31.01.2019, i akuzuari B.N. është liruar nga akuza për veprën penale grabitje në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Të dëmtuarit E.K. dhe I.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të KGJK.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, dhe vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.N., av. B.K., ka paraqitur në përgjigjen në ankesën e Prokurorit në cilën propozon që të refuzohet ankesa e ushtruar nga ana e Prokurorit të shtetit kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan të vërtetohet.

Prokurori i Apelit në parashtresën PPA/I.nr.104/19 të dt. 11.03.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet ashtu që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ndërsa të refuzohet si e pa bazuar përgjigja në ankesën e Prokurorit të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit B.N., av. B.K..

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykimin e ankimuar në të cilën i akuzuari është liruar nga aktakuza, palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan së bashku më shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Në ankesën e Prokurorisë taksativisht theksohet:” Sa i përket aktgjykimit PKR.nr.201/18 të datës 31.01.2019 janë evidente shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat janë të parapara në nenin 384 par.2 nënpar 2.1. të KPPRK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, është kundërtënë me gjendjen faktike apo me faktet vendimtare të cilat janë prezantuar në arsyetim të aktgjykimit nuk kanë lidhmëni me dispozitivin ashtu që e bëjnë edhe më të paqartë aktgjykimin si të tërë sepse provat e proceduara gjatë gjithë seancave gjyqësore edhe të prezantuara në arsyetim nuk kanë refleksione në dispozitivin e aktgjykimit gjithashtu i njëjti ka edhe shkelje tjera për të cilat Gjykata e Apelit duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare”.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të bazuara. Në fakt, sipas ankesës aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nënpar 2.1. të KPPRK, mirëpo pretendimet e cituara më lartë nuk kanë të bëjnë me shkeljet që parashikon dispozita në fjalë, por paraqesin shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar me neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK, andaj kjo Gjykatë i vlerësoi si të tilla.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara e as që ka shkelje tjera për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e që kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK

dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta. Për qëndrimin e vlerësimit të saj, përkitazi me provat e administruara janë dhënë arsye të hollësishme, për çka do të bëhet fjalë në pjesën e aktgjykimit që i referohet gjendjes faktike. Edhe mbrojtja e të akuzuarit ka qenë objekt i vlerësimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ato janë vlerësuar si çdo provë tjetër, në pajtim me nenin 361 të KPPK.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Përkitazi me këtë bazë ankimore Prokurori në ankesë thekson se “Gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar gabimisht ngase elementet përcjellëse të veprës penale janë të parapara në nenin përkatës grabitja në bashkëkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me nën par 1. lidhur me nenin 23 të KPRK, edhe atë sa i përket të akuzuarit ku elementet përcjellëse të kësaj vepre në mënyrë të qartë janë provuar me fakte dhe prova konkrete, ashtu që është për tu befasuar se si të gjitha këto elemente të vërtetuar nuk kanë qenë të mjaftueshme të vërtetohen elementet e veprës penale të paraparë në nenin 255 par.3 lidhur me nën par 1 lidhur me nenin 23 të KPRK”.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Faktet vendimtare që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë me asgjë nuk vihen në dyshim. Në rastin konkret, as me ankesë nuk vihet në dyshim konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ofrohet asnjë provë, asnjë fakt që do të shpinte në konkludimin se i akuzuari B.N. është kryes i veprës penale që i vihet në barrë.

Sipas shkresave të lëndës dhe përshkrimit faktik në dispozitiv të aktgjykimit del se me dt. 19.03.2010, të dëmtuarit E.K. dhe I.K., kanë qenë në vendin e punës në pompën e benzinës “Calabria Petroll” në Gjilan në cilin objekt rreth orës 02:07 minuta kur kanë hyrë dy persona të panjohur. Njeri prej tyre ka shkuar në drejtim të I. me pushkë automatike të drejtuar nga ai, ndërsa tjetri ka shkuar te i dëmtuari E.K., me një thikë duke e mbajtur në mënyrë kërcënuese duke i kërkuar të holla me fjalët “paret, paret krejt çka i keni”. Nuk është kontestues as fakti se nga frika E.K. ia ka dorëzuar afërsisht 230 € nga xhepi. Të dy personat e panjohur kanë qenë me maska të zeza në fytyrë dhe të veshur me pallto të zeza, ndaj të dëmtuarit nuk ua kanë parë fytyrat. Në atë kohë nuk ka pasur kamera të instaluar.

Këto fakte, gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarve E.K. dhe I.K., të cilët pothuajse në mënyrë të njëjtë e kanë përshkruar ngjarjen që ka ndodhur natën kritike dhe kanë bërë përshkrimin e kryesve të veprimeve të përshkruara më lartë.

Mirëpo, kontestues mbetet fakti se a ishte i akuzuari B.N. njëri prej kryerësve të veprës penale, siç pretendon Prokuroria.

Nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar del se gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike i ka administrua të gjitha provat e propozuara nga Prokurori i Shtetit, gjegjësisht ka dëgjua në cilësinë e dëshmitarëve të dëmtuarit E.K. dhe I.K., ndërsa si provë materiale ka administrua foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes. Nga këto prova, ashtu si u tha edhe më

lartë, vërtetohen rrethanat që nuk janë kontestuese, pikërisht rrethanat lidhur me vendin e ngjarjes dhe mënyrën se si ka ndodhur grabitja. Mirëpo, as nga dëshmia e dëshmitarëve e as nga foto-dokumentacioni nuk është vërtetuar asnjë fakt, asnjë rrethanë e cila në çfarëdo mënyrë do të përfshinte të akuzuarin si njërin prej kryerësve të kësaj vepre penale. Dëshmitarët në asnjë fazë të procedurës penale nuk e kanë identifikua të akuzuarin si person që natën kritike ishte në vendin e ngjarjes. Për më tepër, ata në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se nuk kanë pasur mundësi ti njohin personat që janë futur brenda në pompën e benzinës (në vendin e tyre të punës) sepse ishin me maska në kokë, ndërsa dëshmitari E.K. ka pohuar se ata persona kanë qenë ma të gjatë se tani i akuzuari.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartpërmendura, deklaratat e të dëmtuarve e sidomos faktin se Prokuroria në ankesë thekson se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar tregon pa dyshim se qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit si pas aktakuzës sepse i akuzuari me përdorimin e forcës dhe kanosjes ka kryer veprën penale në bashkëkryerje dhe se elementet përcjellëse të kësaj vepre në mënyrë të qartë janë provuar me fakte dhe prova konkrete, por nuk jep asnjë arsye se me cilat prova apo me cilat fakte vërtetohen këto pretendime.

Është fakt se Gjykata, duhet pa tjetër ti vërtetojnë saktë dhe plotësisht të gjitha faktet relevante të çështjes konkrete në të cilat mbështetet aktgjykimi. Konsiderohet se faktet janë të vërtetuara në mënyrë të plotë, po qese gjykata pas vlerësimit të gjitha provave të administruara, konsideron se faktet ekzistojnë dhe se nuk ka fare dyshim për ekzistimin e tyre.

Nga e gjithë kjo rezulton se gjendja e vërtetuar faktike është ajo për të cilën gjykata ka konkluduar (gjetur) se ekziston. Kjo nënkupton se nuk mund të konsiderohen të vërtetuara ato fakte të cilat në të vërtetë nuk burojnë nga rezultati provues dhe rezultati i procedurës në përgjithësi.

Në rastin konkret, me asnjë provë konkrete, me asnjë fakt nuk është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Prandaj, të gjitha ato që janë thënë në aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve si dhe konkludimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me to, si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë, që do të thotë se akcepton arsyet e dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 3 par. 2 të KPPK mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, është i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 99/2019 datë 26.03.2019

Procesmbajtës,

Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro